

Prezantimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil



Kryetari i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, z. Ulsi Manja prezantoi në ambientet e Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), e zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për një mandat 5-vjeçar.



Gjatë fjalës së tij, z. Manja vlerësoi integritetin profesional dhe vizionin e znj. Lleshi, për një administratë publike me standarde të larta dhe të përgatitur për sfidat e integritetit të vendit.



“Sot, në ambientet e zyrës së Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, prezantuar komisioneren e re, znj. Leterije Lleshi (Luzi), një profesioniste me integritet, përvojë dhe vizion të qartë për forcimin e standardeve në administratën publike.

Një falënderim i veçantë për ish-komisioneren znj. Pranvera Strakosha, e cila me punën e saj ka konsoliduar dhe rritur performancën e KMSHC-së, gjatë këtyre viteve.

Kam besim të madh se znj. Lleshi do t'i çojë më tej arritjet e këtij institucioni kaq të rëndësishëm, për të garantuar transparencë, meritokraci dhe standarde në shërbimin civil”, -deklaroi z. Ulsi Manja, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, gjatë prezantimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.